



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	16 - 06 2023	3	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	4797/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.710/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.604/2023 të datës 03.04.2023 dhe ankesën me numër A.nr.710/2023 të datës 05.05.2023 të parashtruar nga ankuesja bashkuara sipas Vendimit VK.Nr./2023 të datës 15.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në ankesën me numër A.nr.710/2023, kundër organit të punësimit/Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.06.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.710/2023 e datës 05.05.2023 e bashkuar me ankesën A.nr.604/2023 të datës 03.04.2023 e parashtruar nga ankuesja

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr. 02-035/02-330 i datës 19.04.2023 i Kryetarit të Komunës së Vitisë.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 02-112/93 të datës 31.01.2012 në pozitën Zyrtare për Barazi Gjinore në Komunën e Vitisë, sipas Vendimit me Nr. 02-035/02-1260 të datës 02.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Vitisë është caktuar Zyrtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi. E njëjta me datë 07.02.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr. 02-320/04-5606 tek Kryetari i Komunës së Vitisë përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e



shtesës mbi pagën bazë sipas vendimit të lartcekura, ndërsa lidhur me këtë nuk ka marr përgjigje.

Ankuesja kundër heshtjes administrative më datë 30.03.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 03.04.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.604/2023 me numër protokoll 3255/2023.

Kryetari i Komunës së Vitisë më datë 19.04.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-035/02-330 përmes të cilit ka bërë shfuqizimin e Vendimit me Nr. 02-035/02-1260 të datës 02.12.2020 për caktimin e ankueses si Zyrtarë për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Ankuesja kundër këtij vendimi më datë 03.05.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 05.05.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.710/2023 me numër protokoll 4070/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 07.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komuna e Vitisë. Ndërsa Këshilli më datë 24.04.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.05.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoll 4234/2023 përmes të cilit ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.604/2023 të datës 03.04.2023 dhe ankesës me numër A.nr.710/2023 të datës 05.05.2023 të parashtruar nga ankuesja për shkak që faktet dhe baza ligjore për vendimmarrje është e njëjtë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankese, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 3255/2023 të datës 03.04.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për kompensim e datës 07.02.2023 e parashtruar nga ankuesja tek Kryetari i Komunës së Vitisë; Vendimin me Nr. 02-035/01-1260 i datës 02.12.2020 i Kryetarit të Komunës së Vitisë; Zarfën e datës 30.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.04.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 24.04.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Barazi Gjinore; Akt Emërimit me Nr. 02-112/93 të datës 31.01.2012; Ankesën me numër protokoll 4070/2023 të datës 05.05.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-035/02-330 i datës 19.04.2023; Pyetësor i vitit 2022; Shkresë me titull Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane-Pani Gjithëpërfshirës i Komunave Janar-dhjetor 2022; Zarfën e datës 03.05.2023; Vendimin VK.Nr./2023 i datës 15.05.2023 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është pabazuar, sepse:



Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil më datë 03.04.2023, pretendon se Komuna e Vitisë duhet të bëjë kompensimin e punës shtesë në pajtim me Vendimin me Nr. 02-035/01-1260 të datës 02.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Vitisë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë, ndërsa në ankesën e datës 05.05.2023 ankuesja pretendon se Vendimi me Nr. 02-035/02-330 i datës 19.04.2023 i Kryetarit të Komunës së Vitisë për shfuqizimin e Vendimit me Nr. 02-035/01-1260 i datës 02.12.2020 është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Rregulloren QRK - Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna dhe Rregullores QRK Nr. 12/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike-administrative si dhe gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses që ndërlidhen me kompensimin e punës shtesë, konstaton se sipas Vendimit me Nr. 02-035/01-1260 të datës 02.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Vitisë ankueses i është caktuar si punë shtesë edhe pozita Zyrtare për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mirëpo nuk është përcaktuar që për këtë punë shtesë ankuesja do të kompensohet.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19, i cili përcakton se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë i cili ka qenë i aplikueshëm deri më datë 05.02.2023, përkatësisht neni 4 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *"Paga e nëpunësve civilë përbëhet nga paga bazë dhe nga shtesat mbi pagën bazë, të përcaktuara me këtë ligj"*, ndërsa referuar nenit 14 të këtij ligji, janë përcaktuar edhe llojet e shtesave që mund të aplikohen ndaj nëpunësve civil, ku përcaktohet se: *"Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"*, ndërsa në mënyrë të hollësishme me akt nënligjor janë përcaktuar edhe mënyrat e realizimit të shtesave që derivojnë nga ky ligj, si rrjedhojë Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 4 ka paraparë llojet e shtesave, ndërsa neni 5 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar llojet e kompensimeve ndaj nëpunësve civil, po ashtu neni 10 dhe 11 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kushtet dhe planifikimin e buxhetit për pagesën e shtesave dhe kompensimeve respektivisht kompensimi për punë jashtë orarit.

Në bazë të provave të lëndës, të dërguara nga ankuesja po ashtu edhe nga organi i punësimit Komuna e Vitisë, Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur asnjë dokument me të cilën do të dëshmohej se ankuesja këtë detyrë e ka ushtruar jashtë orarit zyrtar të punës, si rrjedhojë sipas dispozitave të cekura si më lartë, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensimin e shtesës për faktin se ankuesja nuk mund të kompensohet për punë shtesë nëse nuk ka ofruar dokumentacion përkatës me të cilin do të vërtetohet se ka përmbushur kërkesat ligjore për shtesë mbi pagën bazë, ngase shtesa mbi pagën bazë bëhet vetëm në rastet e



përcaktuar me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenin 4 dhe nenin 5 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, i cili legjislacion kishte qenë në fuqi në këtë kohë, kështu që pretendimet e ankueses sa i përket kompensimit janë të pabazuara, ngase sipas Rregullores QRK - Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna përkatësisht nenit 5 paragrafi 1, është përcaktuar se: *"1. Ministritë dhe komunat, sipas specifikave të fushë veprimtarisë së tyre, me qëllim të zbatimit të Ligjit dhe kësaj rregulloreje, obligohen që të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për mbrojtje nga diskriminimi me kapacitete profesionale dhe të ndajnë burime të mjaftueshme nga buxheti i tyre"*, si rrjedhojë Kolegji konstaton se institucionet përkatëse obligohen të ndajnë buxhet lidhur me këtë fushë por nuk është përcaktuar që duhet të ndajnë buxhet për zyrtarin i cili caktohet për shkak se zyrtari përkatës për mbrojtje nga diskriminimi mund të caktohet ndonjë zyrtar ekzistues apo zyrtari i ri që rekrutohet, ndërsa në rastin konkret të Komunës së Vitisë kjo përgjegjësi i është caktuar një zyrtari ekzistues në këtë rast ankueses.

Sa i përket pretendimeve ankimore të ankueses e cila pretendon se Vendimi me Nr.02-035/02-330 i datës 19.04.2023 i Kryetarit të Komunës së Vitisë për shfuqizimin e Vendimit me Nr. 02-035/01-1260 i datës 02.12.2020 është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Rregulloren QRK - Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna dhe Rregullores QRK Nr. 12/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna, Kolegji i Këshillit, lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju referue Rregullores QRK - Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5, ku përcaktohet se: *"1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim: 1.4. Njësia përkatëse për mbrojtje nga diskriminimi - nënkupton strukturën organizative në kuadër të ministrisë apo komunës, qoftë si njësi ekzistuese apo njësi e re të cilës i caktohen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore; 1.5. Zyrtari përkatës për mbrojtje nga diskriminimi - nënkupton zyrtarin në kuadër të ministrisë apo komunës, qoftë zyrtari ekzistues të cilit i caktohen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore, apo zyrtari i ri që rekrutohet, me kusht që të përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin në fuqi"*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur asnjë dispozitë ligjore me të cilën përcaktohet se Zyrtari për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të caktohet vetëm Zyrtari për Barazi Gjinore, ngase sipas nenit 6 të Rregullores QRK - Nr. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna, është përcaktuar se: *"1. Zyrtar për mbrojtje nga diskriminimi mund të zgjidhet çdo person që plotëson kriteret e përcaktuara me Ligjin për shërbimin civil si dhe që plotëson më së paku kriteret e mëposhtme: 1.1. të ketë diplomë universitare; 1.2. të ketë njohuri dhe përvojë në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe mbrojtje nga diskriminimi"*, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se duke marr parasysh kompetencat e Kryetarit të Komunës të përcaktuar me nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe duke marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenin 53 paragrafi 1 dhe 3, është përcaktuar se: *"1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e*





parë", është në kompetencë të Kryetarit të Komunës të bëjë shfuqizimin e një akti administrativ me një akt të ri.

Andaj lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 02-035/02-330 i datës 19.04.2023 i Kryetarit të Komunës së Vitisë, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh elementet e aktit administrativ të përcaktuar me dispozitat e nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se ky vendim përmban të gjitha elementet e aktit administrativ, mirëpo sa i përket këshillës juridike të këtij vendimi pala është udhëzuar që kundër këtij vendimi mund të parashtroj ankesë në afatin prej 15 ditësh në Komisionin e Ankesave të Komunës së Vitisë, ndërsa duhet të jetë që kundër këtij vendimi pala mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit, edhe pse konstaton se udhëzimi juridik palës i është dhënë gabimisht kjo nuk nënkupton që ankueses i është mohuar e drejta e ankesës, ngase e njëjta ka shfrytëzuar të njëjtën në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, kështu që ky vendim është i ligjshëm, si rrjedhojë edhe pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Nga ato që u thanë më lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.710/2023, datë 16/06/2023.

**Avdyll BEKTESHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së

